



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** me datë **15.11.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arrest në burg” ndaj **personit nën hetim Gjuljo Vuksani**”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, bazuar në nenet 112, 228, 229, 230, 238, 258 dhe 259 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **139**, datë **17.11.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Vleftësimin e ligjshëm të ndalimit të personit nën hetim **Gjuljo Vuksani**, kryer nga policia gjyqësore në datë 14.11.2024 ora 17:55, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Vjedhja*”, me pasojë të rëndë, kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 134/3, 25 i K.Penal.
3. Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ndaj të dyshuarit Gjuljo Vuksani atë të “*Arrest në burg*”, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.
4. Urdhërohet Policia Gjyqësore, që personi nën hetim Gjuljo Vuksani, të dërgohet menjëherë në institucionin e paraburgimit, për të qëndruar aty në dispozicion të organit procedues.
5. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe shërbimet e policisë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brënda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita njoftimit të vendimit të gjykatës.

Tiranë, më datë 17.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar